

GJUHA ARABE ELEMENTI I CILI E LIDH BOTËN ARABE

Nëse një algerian, një egjiptian, një sirian dhe një nga Arabia Saudite do të pyeteshin: “Çfarë ju bën juve të ndiheni arab?”, ata të gjithë, pa dyshim, do të përfshinin gjuhën në përgjigjet e tyre. Në të vërtetë, kjo gjuhë është elementi, i cili e lidh botën arabe nga Maroku deri në Kuvajt. Gjuha arabe ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e njëjtë për të gjithë arabët. Ajo vazhdon që ta pajisë shoqërinë arabe me një ndjenjë të lidhur dhe të fortë të identitetit.

Deri me ardhjen e Islamit në shekullin e shtatë, gjuha arabe ishte kryesisht gjuhë e folur. Kurani, libri i shenjtë i Islamit, iu shpall Profetit Muhamed në gjuhën arabe, duke i dhënë, në këtë mënyrë, gjuhës arabe një domethënie të madhe fetare. Muslimanët besojnë se, për të kuptuar plotësisht mesazhin e Kuranit, ai duhet të lexohet në gjuhën e tij origjinale, në arabisht. Prandaj, rëndësia e gjuhës arabe shtrihet përtej kufijve të botës arabe, ku jetojnë mbi një miliardë muslimanë dhe të gjithë ata përpiqen që ta mësojnë gjuhën arabe për të lexuar dhe për t’u falur në gjuhën e shpalljes.

Fjala e parë: Lexo!

Muslimanët besojnë se fjala e parë, e cila iu shpall Profetit Muhamed ishte ikra, ose “lexo.” Ky është urdhri të cilin Zoti ia dha Muhamedit, kur Profeti nisi që të merrte shpalljet, të cilat më vonë u mblodhën në Kuran. Fjalë për fjalë, Kuran do të thotë “recitim.” Në fakt, folja ikra përmban rrënjën me tri shkronja, në të cilën është bazuar fjala “Kuran” - K, R dhe A (shihni më poshtë “Rrënja dhe sistemi strukturor”). Muslimanët, gjithashtu, e komentojnë këtë urdhër të Zotit si një urdhër ndaj njerëzimit jo vetëm për të mësuar që të lexojnë dhe të shkruajnë, por edhe për të fituar një kuptim të thellë të jetës dhe natyrës shpirtërore përmes mësimin.

Tri format e gjuhës arabe: klasike, standarde moderne dhe e folur

Kurani u bë standardja e pandryshueshme për gjuhën arabe, veçanërisht për formën e shkruar të gjuhës. Arabët e konsiderojnë “arabishten klasike” të Kuranit si bazë të bukurisë dhe përsosmërisë gjuhësore. “Arabishtja standarde moderne,” e bazuar në formën klasike të gjuhës, përdoret në letërsi, mjetet e shtypit, dhe mjetet e komunikimit zyrtar, si p.sh., emisionet e lajmeve. “Arabishtja e folur”, ose dialekti i folur në një vend të caktuar, ndryshon nga vendi në vend dhe nga krahina në krahinë në të gjithë botën arabe.

Format e gjuhës së folur dhe të shkruar të arabishtes janë shumë të lidhura. Në ceremonitë fetare dhe në ligjërimet ose takimet zyrtare, forma e shkruar e arabishtes përdoret gojarisht. Arabishtja standarde moderne përdoret në emisionet e lajmeve në radio dhe në televizion përgjatë botës arabe, duke u lejuar folësve të gjuhës arabe nga vende të largëta, si Libani dhe Maroku, të kuptojnë njëri-tjetrin. Gjatë bashkëbisedimit, megjithatë, folësit e arabishtes nga vende të ndryshme mund të hasin probleme në të kuptuarit e njëri-tjetrit, kur ata flasin në dialektet e tyre përkatëse të vendit. Ata mund të komunikojnë në arabishten standarde moderne, një formë e përdorur zakonisht për takime zyrtare, por ajo mund të duket paksa e rëndë ose e vështirë.

Ndonëse arabishtja e shkruar ka ndryshuar relativisht pak që nga shekulli i shtatë, arabishtja e folur ka marrë shumë ndryshime lokale dhe krahinore. Ajo ka përfshirë, gjithashtu, fjalë të huaja; për shembull, në shekullin e njëzet, shumë fjalë të reja joarabe kanë gjetur mënyrën e tyre brenda gjuhës, veçanërisht fjalë në lidhje me teknologjinë moderne. Ndonëse ka fjalë të barasvlershme për “kompjuter,” “telefon,” “televizion” dhe “radio”, shumë arabë, në të folur, do të përdorin përkthimet angleze ose franceze të këtyre fjalëve.

Në të njëjtën kohë, gjuhët perëndimore kanë huazuar një bollëk fjalësh nga gjuha arabe. Gjatë kulmit të vet, qytetërimi islam ishte konsideruar si një qendër e diturisë dhe arabishtja ishte mjeti për mjekësinë, matematikën, filozofinë dhe astronominë. Fjalë, të tilla si: alkool, algjebër, admiral, alkimi, eliksir, garzë dhe magazinë kanë të gjitha rrënjë nga gjuha arabe. Shumë emra të yjeve rrjedhin nga gjuha arabe; ku përfshihen Betelgeuse dhe Rigel (që të dyja në yjësinë e Orionit), Deneb (në yjësinë Signus), Altair (në yjësinë Akuila), dhe

Aldebaran (në yjësinë Taurus). Veç kësaj, gjuha spanjolle dhe ajo portugeze përmbajnë një bollëk fjalësh me origjinë arabe, për shkak të lulëzimit të qytetërimit arab në Gadishullin Iberik nga shekulli i tetë deri në shekullin e pesëmbëdhjetë.

Karakteristikat e gjuhës arabe

Arabishtja është gjuhë semite, njësoj si hebraishtja dhe aramaishtja. Ajo ka 28 shkronja, shumë prej të cilave janë shkronja të ngjashme me alfabetin romak, dhe shkruhet nga e djathta në të majtë. Shkronjat ose tingujt e barasvlershëm me P dhe V nuk ekzistojnë në gjuhën arabe. Anasjelltas, shumë nga tingujt e shkronjave në gjuhën arabe janë të panjohur për folësit e disa gjuhëve të tjera. Për shembull, tingulli grykor ajn krijohet duke e shtrënguar fytyrën dhe nuk ka të barasvlershëm në gjuhët perëndimore (në tekstin e transkriptuar ai shënohet shpesh me një apostrofë). Tingulli gajn i ngjan tingullit francez “r” dhe tingulli kha tingëllon si “ch” e thellë gjermane. Disa shkronja arabe përfaqësojnë tingujt që shkruhen si dy shkronja në gjuhë të tjera, si p.sh., shkronja shin, që jep tingullin “sh”, dhe shkronja tha siç shqiptohet në fjalën “thin”.

Gjuha arabe ka gjashtë zanore: një “i” të gjatë; një “i” të shkurtër; një “a” të gjatë; një “a” të shkurtër; një “u” të gjatë; dhe një “u” të shkurtër. Të tri zanoret e gjata (i, a dhe u) përcaktohen nga shkronja të veçanta, ndërsa shkronjat e shkurtra shënohen me shenja theksimi. Prandaj, shumë fjalë arabe shkruhen si një varg me bashkëtingëllore, me shenja theksimi që shoqërojnë shkronjat për të treguar zanoret. Në të shkruarit e përditshëm, këto zanore shpesh nuk përdoren; lexuesi i njeh fjalët si pasojë e përvojës si dhe e kontekstit.

Përveç formimit të njëjësit dhe shumësit, gjuha arabe ka një formë të quajtur “e dyfishtë”, e cila tregon pikërisht dy gjëra. Për shembull, një stilolaps shkruhet kalem, dy stilolapsa bëhet kalemejn dhe shumë lapsa bëhet aklam. Njësoj si në frëngjisht, spanjisht, dhe shumë gjuhë të tjera, emrat arabë nuk kanë gjini, ndërsa foljet dhe mbiemrat pranojnë gjini. Në arabishten e shkruar, fundet e rasave përdoren për të treguar pjesë të ligjëratës (njerëz, sende, shprehje parafjalore etj.), në një formë të njëjtë me latinishten dhe gjermanishten.

Shkronjat arabe janë të lidhura bashkë për të formuar fjalë të një lloji; nuk ka dallim mes shkrimit të shtypit apo shkrimit kursiv, si në

anglisht. Po ashtu, nuk ka shkronja të mëdha dhe të vogla - të gjitha shkronjat janë njësoj. Forma e shkronjës, megjithatë, ndryshon në varësi të vendndodhjes së saj në një fjalë (në fillim, në mes, në fund). Disa prej tyre bashkohen vetëm nga njëra anë, ndërsa të tjera nga të dyja anët. Format e shkronjës përfshijnë lakime dhe pika, si dhe veçori të tjera të cilat i japin shkrimit një vlerë artistike.

Rrënja dhe sistemi strukturor

Ndoshta aspekti më i rëndësishëm i gjuhës arabe është rregulli i formës së saj. Fjalët arabe, në përgjithësi, përftohen nga rrënjët me tri shkronja, të cilat ndryshojnë sipas rregullave të veçanta për të ndërtuar grupe fjalësh, kuptimi i të cilave lidhet me njëri-tjetrin. Familje të gjera fjalësh në gjuhën arabe ndërtohen duke i shtuar parashtesa, infikse (shkronja të shtuara brenda fjalës), dhe prapashtesa një rrënje me tri shkronja në një varg strukturash të caktuara. Në të vërtetë, kur përdoret një fjalor i gjuhës arabe, fjalët nuk duhen parë vetëm në mënyrë alfabetike. Rrënja me tri shkronja, në fillim duhet të përcaktohet dhe, më pas, ajo mund të vendoset në mënyrë alfabetike në fjalor. Poshtë rrënjës, janë vendosur fjalë të ndryshme të cilat i përkasin asaj familjeje fjalësh.

Më poshtë gjenden disa nga fjalët e formuara nga rrënja me tri shkronja XH-L-S.

XheLeSe - të ulësh
eXhLeSe - të ulet (dikush)
XhiLSe - mënyrë e të ulurit
XhuLuS - (veprimi i) të ulurit
iXhLiS! - ulu!
XheLSa - takim ose mbledhje
XheLiS - shoqërues; pjesëmarrës në një takim shoqëror (fëmërorja bën XheLiSa)
meXhLiS - seancë ose mbledhje
muXheLeSe - shkëmbim ose komunikim shoqëror

Emrat arabë

Shumë familje arabe vazhdojnë të ndjekin zakonet tradicionale të vendosjes së emrave. Djali i parë që lind, për shembull, do t'i vë djalit të tij të parë emrin e babait të tij. Meqenëse shoqëria arabe është trashëgimore, vajzat dhe djemtë marrin emrin e babait të tyre si emër të dytë dhe mbiemrin e tij e marrin si të tyre. Të gjithë emrat kanë nga një kuptim - shpesh u vënë emrat e një personaliteti të shkëlqyer (p.sh., Kerima do të thotë bujare ose fisnike; Zaki do të thotë inteligjent). Si në shumë pjesë të botës, emrat arabë shpesh shënojnë një profesion për të cilin familja është njohur dikur, si Haddad (Farkëtar), ose Habbaz (Furrтар). Mbiemrat mund të paraqesin, gjithashtu, qytetin e familjes ose vendin e origjinës, si Akkavi (nga Akka, ose Akre, në Palestinën historike) ose Humsi (nga Hums, në Siri).

Kur lexohet historia arabe, ndeshen shpesh fjalët Ibn (ose Bin) dhe Bint, që duan të thonë përkatësisht "djali i" dhe "vajza e". Prandaj, Ibn Halduni ose Ibn Battuta tregojnë djali i Haldunit dhe djali i Battutës, dhe Zejnebe Bint Xhehsh do të thotë Zejnebja, vajza e Xhehshit. "Benu" ose "Beni" është shumësi i Ibn; prandaj, Benu Hashim do të thotë fëmijët (ose pasardhësit) e Hashimit, dhe Beni Adam do të thotë pasuesit e Ademit (Adamit). "Ebu" do të thotë "babai i" dhe "Umm" do të thotë "nëna e"; pra: Ebu Seleme dhe Umm Seleme janë prindërit e djalit të quajtur Seleme.

Në Islam, Zoti (Allahu në arabisht) ka nëntëdhjetë e nëntë emra, ku të gjithë ata emra përshkruajnë mirësinë dhe madhësitinë e Tij. Këto janë atributet të cilat janë përmendur në Kuran dhe Hadith (thëniet e Profetit Muhamed). Shumë emra arabë janë formuar duke bashkuar fjalën Abd (do të thotë "shërbyes i") me një nga 99 emrat e Zotit. Prandaj, Abd Allah (që shpesh shkruhet si Abdallah, ose Abdullah) do të thotë Shërbyes i Zotit. Më poshtë janë disa shembuj të tjerë. Vini re se parashtesa "al" është shquesi i fjalës:

Abd al-Rahman - Shërbyes i të Mëshirshmit
Abd al-Xhebbar - Shërbyes i të Plotfuqishmit
Abd al-Hakim - Shërbyes i të Urtit.

Kur këta emra përdoren në një gjuhë tjetër, ata shpesh shkruhen si Abdul Rahman dhe Abdul Xhebbar. Nuk është një mënyrë e drejtë ose e gabuar që këta emra të transiliterohen, me kusht që të kuptohet se “Abdul” zakonisht nuk qëndron vetëm si emër. Për më tepër, ai do të thotë “shërbyes i” dhe duhet ndjekur nga një prej 99 emrave të Zotit.

Më poshtë janë shënuar disa emra të tjerë arabë të zakonshëm dhe kuptimet e tyre.

Emra femërorë

Muna - shpresë, dëshirë

Lejla - natë

Hanan - butësi, dhembshuri

Selva - ngushëlluese, shpëtimtare

Samira - shoqëruese

Nur - dritë

Aisha - e gjallë, e begatë

Emine - besimtare, që ka besim, paqedashëse

Fatime - vajza e Profetit Muhamed

Hadixhe - gruaja e parë e Profetit Muhamed

Emra mashkullorë

Sherif - i nderuar

Xhemil - i bukur

Umer - me jetë të gjatë, i lulëzuar

Rashid - udhëheqës i drejtë, i arsyeshëm

Selim - i sigurt, i patëmetë

Ferid - unik, i pakrahasueshëm

Emin - i besuar, besnik

Halid - i përhershëm, i përjetshëm

Muhamed, Ahmed, Mahmud - i lavdëruar

Ali - i lartësuar, i lartë

Hasan, Husein - i bukur, më i miri

Emra biblikë

Ibrahim - Abraham

Davud - David

Isa - Jezusi

Hava - Eva

Musa - Mojsi

Jusuf - Jozef

Henna - Gjon

Sara - Sara

Merjeme - Maria

Kaligrafia arabe

Siç u përmend më herët, format e shkronjave arabe dhe stili i lirshëm i shkrimit i japin gjuhës arabe fuqi të madhe artistike. Në të vërtetë, kaligrafia arabe gjendet në të gjithë botën islame dhe mund të shihet si në mjedisin fetar, ashtu edhe në atë laik.

Një thënie (hadith) i Profetit Muhamed thotë: "Kaligrafia e bukur e qartëson më shumë besimin". Meqë komuniteti musliman është rritur, kaligrafia arabe është përshtatur në përdorime të ndryshme. Për shembull, shkrimi i Kuranit ka nevojë që të jetë më i bukur dhe më i kuptueshëm. Ngaqë letra ishte e shtrenjtë, shkrimi i ngjeshur u përdor për punë dhe korrespondencën personale. Kaligrafia dekorative në ndërtesa, përpunimin e metalit dhe tekstile është zbuluar (stolisur) gjerësisht dhe është riprodhuar në stile të llojeve të ndryshme - elegante dhe të rrjedhshme, ose këndore dhe gjeometrike. Në këtë mënyrë, modelet kaligrafike u shtuan dhe vazhdojnë të zhvillohen edhe në ditët tona.

Disa nga karakteristikat e kaligrafisë arabe janë përpjesëtimi, simetria, përsëritja dhe stolisja. Shkronjat horizontale, si "ba" dhe "sin", mund të zgjaten për të mbushur një hapësirë ose formë të veçantë, ose për të shtuar një cilësi dramatike. Shkronjat vertikale, si "elif" dhe "lam", mund të shtrihen, të bëhen të pjerrëta, ose të shndërrohen në një model pingul. Dikush mund të "ndiejë" lirshmërinë e shkrimit në një drejtim të veçantë. Lakimet, pikat dhe shenjat e theksimit ngjallin interes, ekuilibër dhe zbulim, si dhe ndihmojnë për një kuptim më të përgjithshëm të rregullit dhe

harmonisë.

Kaligrafët arabë ndonjëherë ndërtojnë kaligramë - fjalë ose shprehje të cilat u përshtaten formave ose figurave të veçanta, si p.sh., të një drejkëndëshi ose të një kafshe. Një kaligram mund të përfshijë, gjithashtu, "shkrimin përmbys", ku kaligrafia e fjalës ose e shprehjes është një imazh përmbys i përkryer në secilën anë të një vije të përfytyruar të simetrisë. Shumë herë këto kanë një cilësi si labirinte dhe, në të njëjtën kohë, një vlerë enigmatike dhe tërheqëse estetike.